

PËRSHËNDETJE TË DASHUR QYTETARË!

Ne e dimë se teknologjia mund të duket pak e ndërlikuar, sidomos kur nuk je mësuar me të.

POR MOS U SHQETËSONI!

Ky udhëzues është krijuar për t'ju ndihmuar që të informoheni rreth shërbimeve publike online.

QËLLIMI YNË ËSHTË QË JU TË NDIHENI TË FUQIZUAR DHE TË PAVARUR NË PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË.

@ Ky material është prodhuar në kuadër të Projektit "Përfshirja dixhitale për OSHC - të dhe Angazhimin e Qytetarëve në Bashkëpunimin Rajonal (DIGI-CORE), me mbështetje nga SMART Balkans dhe i zbatuar nga "Qendra Sociale në Ndhim të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz (QSNNN), Instituti Edutask, dhe Qendra për Inovacionet Sociale "Blink 42-21". Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e "Qendrës Sociale në Ndhim të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz (QSNNN) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) as të konsorciumit SMART Balkans.





NJË MESAZH FRYMËZUES PËR JU:

Përdorimi i teknologjisë mund të duket sfidues në fillim, por me pak praktikë, do të bëhet pjesë e jetës suaj të përditshme. Ju keni mundësinë të bëheni pjesë e këtij revolucionit digjital, duke përdorur e-Kosova për të përmirësuar cilësinë e jetës suaj.

Mos harroni, çdo hap i vogël drejt teknologjisë është një hap i madh drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të lehtë për ju dhe të dashurit tuaj.

BROSHURË PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE ONLINE





ÇFARË ËSHTË E-ALBANIA DHE SI MUND T'JU NDIHMOJË?

Platforma qeveritare e-Albania ofron akses online në shërbimet elektronike publike në Shqipëri. Qytetarët dhe bizneset mund të shkarkojnë dokumente ligjore në kohë reale, duke përdorur një kompjuter, tablet apo smartfon, pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht në sportelet shtetërore.

Që nga viti 2020, aplikimet për shërbime publike kryhen vetëm online përmes e-Albania. Administrata publike mbledh dhe ripërdor dokumentet shtetërore, duke lehtësuar procedurat për qytetarët.

Portali është i integruar me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, duke mundësuar shkëmbimin elektronik të të dhënave mes institucioneve publike për ofrimin e shërbimeve më efikase.

PSE DUHET TA PËRDORNI E-ALBANIA?



Lehtësi dhe Komoditet:

Nuk keni më nevojë të prisni në radhë ose të shkoni në zyrat shtetërore. Gjithçka mund ta bëni nga shtëpia.



Kursim Kohe:

Shërbimet janë të disponueshme 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Kjo do të thotë që mund t'i përdorni kur ju përshtatet më shumë.



Siguri dhe Besueshmëri:

Shërbimet online janë të sigurta dhe të mbrojtura nga teknologjitë më të fundit të sigurisë.

SI TË FILLONI ME E-ALBANIA?



Hapni një llogari:

Nëse nuk keni ende një llogari, mund ta krijoni lehtësisht duke ndjekur disa hapa të thjeshtë në faqen e e-Albania.



Identifikohuni:

Pasi të keni llogarinë tuaj, identifikohuni për të hyrë në portal dhe për të filluar përdorimin e shërbimeve.



Zgjidhni shërbimin që ju nevojitet:

Pasi të jeni futur në portal, kërkoni shërbimin që ju nevojitet dhe ndiqni udhëzimet e thjeshta për të përfunduar kërkesën tuaj.

CILAT SHËRBIME MUND T'I MERRNI?



Dokumente me vulë elektronike



Gjendja gjyqësore



Pagesa elektronike Familja – certifikata të ndryshme



Shërbime për bizneset Leje dhe licenca të ndryshme



Arsimi – regjistrimi, kurse profesionale, aplikime për institucione arsimore



Transport dhe automejete – leje drejtimi dhe qarkullimi, gjoba dhe taksa



Punë e shërbime për punëkërkuar, punëdhënës



Pasuri e paluajtshme – certifikata, aplikime dhe vërtetime të ndryshme



Shëndetësia dhe mbrojtja sociale



Shërbime konsullore – pasaporta, vize, leje, akte noteriale, legalizime, shtetësia



Kontribute dhe pensione – aplikime, kërkesa, vërtetime



Shërbime doganore – vërtetime, autorizime, licenca

SI MUND T'JU NDIHMOJMË MË TEJ?

Nuk jeni vetëm!

Nëse hasni ndonjë vështirësi, ju mund të kontaktoni ekipin tonë të mbështetjes në çdo kohë. Ata janë këtu për t'ju udhëhequr hap pas hapi.

Frymëzohuni!

Përdorimi i teknologjisë është një mënyrë për të qëndruar të lidhur dhe për të përfituar nga shërbimet e rëndësishme për të cilat keni nevojë. Ju jeni në gjendje të mësoni dhe të përmirësoni jetën tuaj përmes këtyre mjeteve.